

Donika Xhemajli

Rezistenca e pakicave

Shembulli i shqiptarëve të
Kosovës në Mbretërinë SKS





Pyetja kyçe

- Deri në cilën masë shqiptarët e Kosovës nuk e pranonin Mbretërinë SKS?
- Deri në cilën masë shteti nuk i pranonte Shqiptarët e Kosovës?



Tema:

Moduli flet për të drejtat dhe kërkesat e pakicave në Mbretërinë SKS. Pakënaqësia e pakicave, veçanërisht e shqiptarëve të Kosovës dhe rezistenca e tyre ndaj Mbretërisë SKS, dëshira për bashkim me Shqipërinë, ose me inkuadrimin e barabartë në politikë, jeta shoqërore dhe politike në Mbretëri, është temë kontroverse historike e cila edhe më tepër i ngacmon emocionet. Moduli e përfshinë periudhën nga vitit 1912 deri në vitin 1930. Kjo temë është zgjedhur me qëllim që të rinjtë të mësojnë dhe kuptojnë me çfarë sfida është ballafaquar pakica shqiptare në të kaluarën.



Qëllimet:

- Kuptimi kritik i natyrës së ndërlikuar të së kaluarës
- Kuptimi i çështjes kombëtare shqiptare
- Përkrahja e nxënësve në kuptimin e mënyrës dhe shkaqeve të rezistencës
- Zhvillimi i vetëdijes historike



Rezultatet e mësimit

- Njohja e kërkesave dhe pakënaqësive të shqiptarëve të Kosovës në Mbretërinë SKS;
- Krahاسimi dhe analiza e mënyrave të ndryshme të rezistencës;
- Vlerësimi i pjesëmarrësve ose ngjarjeve të mëhershme në kontekstin dhe rrethanat historike;
- Krahاسimi i shkaqeve dhe pasojave të ngjarjeve historike si problem kombëtare, sfida ose rrëfim i pambaruar.

Udhëzime për mësimdhënësin

Hapi 1. Mësimdhënësi shkruan shirit kohe në tabelë dhe kërkon nga studentët që t'i ndajnë materialet e parapara për hyrje sipas rendit kronologjik.

Hapi 2. Në bazë të materialeve secili nxënës shkruan vështrim të shkurtër historik.

Hapi 3. Diskutim.

Hapi 4. Mësimdhënësi formon 5 grupe, i ndanë materialen dhe në të njëjtën kohë u jep pyetje nxënësve. Secili grup ka pyetje të veçanta.

- Grupi 1. Pozita e Mbretërisë SKS
- Grupi 2. Opozita aktive jolegale
- Grupi 3. Opozita legale
- Grupi 4. Shteti shqiptar
- Grupi 5. Veprimet e shqiptarëve në Kosovë

Hapi 5. Nxënësit punojnë në grupe. Nxënësit i lexojnë materialet dhe përgatiten t'i paraqesin përgjigjet e tyre. Gjatë kësaj kohe mësimdhënësi kalon pranë grupeve, e vështron punën e nxënësve dhe jep informata shtesë, nëse ka nevojë. Materiali prezantohet në flipçart.

Hapi 6. Secili grup do ta prezantojë punën e vet para klasës dhe do t'u përgjigjet pyetjeve.



90
minuta



Who	SKS Kingdom	Illegal opposition	Legal opposition	Albanian State	Albanian minorities and international engagement
What?					
How?					

Duke u bazuar në vendimet e sjella në Konferencën e Londrës (1912-1913), shqiptarët ishin të pakënaqur. Gjithashtu popujt e tjerë të Ballkanit ishin të pakënaqur. Greqia pretendonte më shumë territor në jug të Shqipërisë, Serbia kërkonte së paku pjesë të Shëngjinit ose në rastin më të mirë territore deri në Durrës. Shqiptarët që mbetën jashtë Shqipërisë në vitin 1913, veçanërisht shqiptarët e Kosovës, nuk i ndërprenë kërkesat për bashkim me Shqipërinë. Kjo ishte kërkesë e një grupi të rezistencës të shqiptarëve të Kosovës. Grupi tjetër kërkonte trajtim të njëjtë dhe të barabartë si popujt e tjerë në Mbretërinë SKS. Në ndërkohë, territoret me popullsi shumicë shqiptare në Mbretërinë SKS, si Kosova, Maqedonia Perëndimore, Presheva, Medvegja dhe Bujanoci me rrethinë dhe një pjesë e Malit të Zi, ishin territoret me zhvillim më të ulët ekonomik.

Gjendja e këtillë ekonomike nuk ishte kryesisht për shkak të rrethanave politike, por gjithashtu situatë e trashëguar nga Perandoria Osmane e prapambetur. Zhvillimi më i ulët bujqësor ishte karakteristik për këtë pjesë gjatë Mbretërisë SKS. Kjo gjendje sociale, solli deri te gjendja e padurueshme dhe kontradiktat mes gjendjes së punëtorëve dhe fshatarëve të cilët kishin obligime ndaj pushtetmbajtësve. Problemi kryesor ishte çështja e pazgjidhur nacionale. Në realitet, politika centraliste e Mbretërisë SKS e thelloi problemin e bashkëjetesës mes popujve dhe rendit shtetëror në Mbretërinë SKS.

Burimi 1

Filli i ngatërruar

Viti i Ri: "Halla Evropë, më duket se kjo të është ngatërruar. Do të na duhet e gjithë koha e kësaj bote për ta rregulluar"



<http://archive.org/stream/punchvol144a145lemouoft#page/n53/mode/2up>
21.12.12

Burimi 2

Djepi i thyer

EVROPA: "Oh, hesht ti, vogëlushi im!"
Fëmija Shqipëri: "Si mund të heshti unë, me gjithë këtë zhurmë rreth meje?"
EVROPA: "Mirë, duhet të bësh si bëj unë, dhe të shtresh se nuk dëgjon"



<http://archive.org/stream/punchvol144a145lemouoft#page/90/mode/2up>
21.12.12

Burimi 3

Krijimi i shtetit Shqiptar dhe pranimi i tij ndërkombëtar

Edhe krahas intervenimeve ushtarake të aleatëve ballkanikë, patriotët shqiptarë të cilët e mbajtën barrën më të madhe të lëvizjes për çlirimin e atdheut të tyre, u takuan në Vlorë, më 28.11.1912 dhe e shpallën Shqipërinë shtet të pavarur. Kuvendi popullor e emëroi qeverinë e përkohshme e cila e formoi komitetin për mbrojtjen e çështjes shqiptare para fuqive të mëdha. Kuvendi popullor nga Vlora u dërgoi telegrame Fuqive të Mëdha në të cilat, mes tjerash thuhej që "shqiptarët të cilët kishin hyrë në familjen e popujve të Evropës Lindore, në të cilën ndjehen krenarë që janë populli më i vjetër, uuë.9 (p) -f100 ()

Burimi 4

Ismail Qemali dhe Isa Boletini

Isa Boletini ishte patriot shqiptar dhe luftëtar gueril, i lindur në fshatin Boletin afër Mitrovicës, i cili u bë figurë e rëndësishme e rezistencës shqiptare kundër osmanlinjve, Serbisë dhe Malit të Zi.

Ismail Qemali ishte figura kryesore e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912. Ai ishte kryeministër i Qeverisë së Përkohshme të Shqipërisë nga vitit 1912 deri në vitin 1914.

Libri shkollor "Historia 9", Fehmi Rexhepi, f. 23, 2011
<http://www.nasergashi.com/t4847-foto-historike-isa-boletini>
12.04.2013



Isa Boletini
(1864-1916)

Ismail Qemali
(1844-1919)

Burimi 5

Vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër 1913

Konferenca e Londrës, ose Konferenca e Ambasadorëve siç njihet zakonisht në historinë shqiptare, ishte një mbledhje e gjashtë Fuqive të Mëdha (Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Austro-Hungaria, Rusia dhe Italia), për të zgjidhur probleme të caktuara në Ballkan që kishin lindur si rezultat i rënies së Perandorisë Osmane. Filloi me punë më 17 dhjetor 1912 nën drejtimin e sekretarit të jashtë britanik, Sër Edqard Grey (1862-1933), pas Luftës së Parë Ballkanike dhe shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë më 28 nëntor 1912. Më 30 maj 1913 u arrit një marrëveshje sipas së cilës Turqia do të heqë dorë nga të gjitha territoret në perëndim të linjës Enos-Midia.

Për sa i përket Shqipërisë, ambasadorët fillimisht kishin vendosur se vendi do të njihet si shtet autonom nën sovranitetin e sulltanit. Pas shumë diskutimeve, megjithatë, ata arritën një vendim formal se Shqipëria, ndonëse e privuar nga pothuajse gjysma e territorit të saj etnik (veçanërisht Kosova), do të bëhej shtet sovran i pavarur nga Perandoria Osmane. Ky vendim, i arritur në mbledhjen e pesëdhjetekatër të konferencës më 29 korrik 1913, u formulua shkurtimisht në njëmbëdhjetë pikat e mëposhtme dhe hodhi bazat për njohjen ndërkombëtare të pavarësisë së Shqipërisë.

1. Shqipëria është konstituuar si një principatë autonome, sovrane dhe trashëgimore me të drejtën e paralindjes, të garantuar nga gjashtë Fuqitë. Sovrani do të caktohet nga gjashtë Fuqitë.
2. Çdo formë e sovranitetit midis Turqisë dhe Shqipërisë përjashtohet.
3. Shqipëria është neutrale; neutraliteti i saj garantohet nga gjashtë Fuqitë.
4. Kontrolli i administratës civile dhe financat e Shqipërisë do të jepen nëpërmjet një Komisioni Ndërkombëtar të përbërë nga delegatët e gjashtë Fuqive një delegat nga Shqipëria.
5. Kompetencat e këtij komisioni do të zgjasin për dhjetë vjet dhe mund të zgjaten nëse është e nevojshme.

http://www.albanianhistory.net/texts20_1/AH1913_2.html 28/05/2013


Burimi 6

Fuqitë e Mëdha rajonin e banuar me shqiptarë, Kosovën, i dhanë Serbisë dhe pjesën më të madhe të regjionit jugor të Çamërisë Greqisë. Afërsisht, gjysma e territoreve të banuara kryesisht nga shqiptarët, dhe 40% e popullsisë u lanë jashtë kufirit të shtetit të ri.

Historical overview page.675 Janusz Bugajski; *Political Parties of Eastern Europe: A Guide to Politics in the Post-Communist Era* 12.04.2013

Burimi 7

Kufijtë e propozuar të Shtetit Shqiptar



Kufijtë e shtetit shqiptar më 1913

Çka kërkonin shqiptarët

Propozimi i Shteteve Ballkanike

Kufijtë e krijuar nga Konferenca e Londrës

Libri shkollor "Historia 8", Fehmi Rexhepi & Frashër Demaj, fq. 133, 2011

Burimi 8

Edward Grey opinion për vendimet e Konferencës së Londrës

Edward Grey ishte i vetmi në mesin e Ministrave të Jashtëm në Konferencë i cili ishte i vetëdijshëm për padrejtësinë gjatë vendosjes së kufijve të Shqipërisë. Në mesin e deklaratave të tija të botuara në vitin 1913 (E. Grey, Speeches on Foreign Affairs, London 1913) është edhe ajo për kufijtë e Shqipërisë. "...Jam i vetëdijshëm, - thotë Grey- se kur do të dihen rezultatet, kjo zgjedhje e kufijve, në shumë çështje do t'i japë arsye secilit i cili do ta gjykojë këtë rast thjesht nga perspektiva lokale..."

Pavarsia Shqiptare dhe Diplomacia e Fuqive të Medha 1912-1914", Arben Puto, p.24, Tiranë 2012

Burimi 9

Krijimi i Mbretërisë SKS 1918

Me krijimin e Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve, më 1 dhjetor 1918, Kosova gjithashtu bëhet pjesë e kësaj Mbretërie. Pakicës myslimane nuk i ishin dhënë të drejta nacionale, dhe kjo ishte arsyeja që ata të organizohen për të drejtat politike dhe nacionale. Në vitin 1919 ata themeluan parti politike, dhe kjo parti e botonte organin e saj. Mes dy luftërave botërore, Kosova ishte zona më e varfër dhe më pak e zhvilluar në Mbretëri.

B. Koro, tahir 9, Prishtina 2008, p. 57-59

Burimi 10

"Idealni" cilj Albanaca na Kosovu

"Bez jake i slobodne Albanije, svaka aktivnost za Kosovo i druge teritorije je uzaludna."
1918-1924.

"Narodna odbrana Kosova (Komiteti Mbrojtja Komëtare e Kosovës - MKK)" 1918-1924.

Burimi 11

Ideali i shqiptarëve të Kosovës

"Pa Shqipëri të fortë dhe të lirë çdo aktivitet për Kosovën dhe territoret e tjera është i kotë".

Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës (MKK) 1918-1924

L.Culaj, Komiteti Mbrojtja Komëtare e Kosovës 1918-1924, Prishtinë 1997, p.41

Grupi 1

Pozita e Mbretërisë SKS

Pyetje:

1. Cila ishte pozita e qeverisë përkundër pakicës shqiptare?
2. Çka do të thotë ajo që ligji është i njëjtë për të gjithë qytetarët? Sqaro!

Burimi 1

RAPORTI I UDHËHEQËSIT TË DELEGACIONIT NË KONFERENCËN PAQËSORE DREJTUAR KRYEMINISTRIT NË BEOGRAD PËR ÇËSHTJEN SHQIPTARE

Kryeministrit.

Personalisht dhe sekret.

Zgjedhja e çështjes shqiptare vjen nga fundi. Është ngushtë e lidhur me çështjen e Adriatikut, ndërsa çështja e Adriatikut tani është sërish në radhë dhe mundohet të gjendet zgjidhja të cilën do ta pranojnë Uilsoni, d.m.th. qeveria amerikane dhe Italia. Aleatët tanë, d.m.th. Francezët dhe Anglezët, vërtet mbajnë llogari për kërkesat tona, por mendojnë që do të mund ta pranojnë atë zgjidhje që do të pajtohet Uilsoni. Çështja shqiptare lidhet me atë të Adriatikut së pari për shkak të asaj që është në lidhje të natyrshme me atë, ndërsa gjithashtu edhe pse llogaritet si mjet i kompensimit. Sipas Marrëveshjes së Londrës, sipas së cilës Italisë i jepet Vlora dhe i jepet njëfarë protektorati në Shqipërinë e mesme, Shqipëria veriore i jepet Malit të Zi dhe Serbisë. Ne nuk e kërkojmë Shqipërinë Veriore për vete, por kërkojmë që atyre fiseve t'u jepet e drejta për vetëvendosje, që ata vet të thonë a duan të bashkohen me Shqipërinë e mesme myslimane, e cila do të vjerë nën protektoratin Italian, apo duan të krijojnë shtet të vogël të pavarur, si një "tampon shteti", apo duan t'i bashkëngjiten si shtet autonom shtetit tonë. Në çdo rast ne pretendojmë në vijën kufitare të lumit Drin dhe Drini i Zi.

Branko Petranović, Momčilo Zečević: JUGOSLAVIJA 1918-1988. TEMATSKA ZBIRKA DOKUMENATA

Burimi 2

Marrëveshja për mbrojtjen e pakicave

Në dhjetor të vitit 1921 Mbretëria SKS e nënshkroi marrëveshjen për mbrojtjen e pakicave. Marrëveshja është bërë që të sigurojë "siguri të plotë të jetës dhe lirisë së qytetarëve të Mbretërisë, pa dallim të përkatësisë nacionale, gjuhësore, racore ose fetare"

Noel Malcolm, "Kosovo: A short history" p. 345. 2011

Burimi 3

Ligji i nacionaliteteve i Mbretërisë SKS i vitit 1928 nuk e vërtetonte statusin e atëhershëm nacional, por në mënyrë të qartë shprehej që ai status është formuar për herë të parë: Shqiptarët që cilët jetonin në Kosovë, nga mesi i vitit 1913 deri në konstituimin e Jugosllavisë së vitit 1918, ishin të njohur si (paragrafi 4, neni 55) "josllavë të cilët u bënë qytetarë të Mbretërisë në përputhje me paragrafin 2 të nenit të njëjtë".

Pop-Kosic, "Etude juridique (LEGAL STUDY)", page 105-15

Burimi 4

Shteti i serbëve, kroatëve dhe sllovenëve i pranon të gjitha rregullat, duke vendosur që këto rregulla të barten në një marrëveshje me fuqitë kryesore të bashkuara, të cilat fuqi do të konsiderohen si të nevojshme në shtetin SKS për shkak të mbrojtjes së interesave të atyre banorëve të cilën nga shumica e banorëve dallojnë për nga raca, gjuha dhe feja... Shteti i mbretërisë SKS obligohet që të gjithë banorëve t'u jep mbrojtje të plotë të jetës dhe lirisë pa e marrë parasysh prejardhjen, kombësinë, gjuhën, racën ose fenë.

Balkanski ugovorni odnosi, 1876 – 1996, 1, Beograd, 1998, 41-51

Burimi 5

Rregullimi kushtetues i pozitës dhe të drejtave të pakicës (Kushtetuta e vitit 1921)

Gëzimi i të drejtave qytetare dhe politike është e pavarur nga feja. Askush nuk mund të lirohet nga obligimet e tija qytetare dhe ushtarake duke u thirrur në rregullat e fesë së vet (neni 12, paragrafi 1 dhe 2).

Y 1921

Burimi 6

Burimi 6

Ministri i Punëve të Jashtme Marković për pozitën e Mbretërisë SKS për pakicat

... për regionet tona jugore që i janë aneksuar shtetit tonë para janarit 1919, qëndrimi ynë është se atje nuk ka pakica. Ky qëndrim është vendimi përfundimtar për çështjen e pranimi të pakicave në Serbinë jugore.

...peticionet dhe ankesat që i dërguan shqiptarët në Lidhjen e Kombeve nuk duhet të merren në shqyrtim, sepse sipas tij, këto kërkesa të "turpshme" e ofendojnë dinjitetin e shtetit....

N. Malcolm, "Kosovo: A short history" Prishtinë 1997, f. 346 Sipas: Central Albanian Archive of the Albanian Republic: The Fund of the Foreign Affairs Ministry of the Albania (dok. 194; nr. 489; f. 252) Foreign Minister of YU Markovic Geneva, 23 Shtator 1930;

Grupi 2

Opozita aktive ilegale

Pyetje:

1. Si organizoheshin njerëzit të cilët ndjeheshin të pabarabartë në shtetin në të cilin jetonin?
2. Çka i detyronte grupet e caktuara që shtetit t'i kundërvihen me armë?

Burimi 1

Qasjet e ndryshme për zgjidhjen e çështjes së pakicës shqiptare



Hoxhë Kadri Prishtina
(1878-1925) Udhëheqës i
MKK-së
"Shqipëria e pavarur e
përfashtuar nga çdo
protektorat"
"Shpëtimi i Kosovës" duhet
të bëhet me masa politike
bile edhe të pjesërisme.

Çështje nga historia moderne
dhe bashkëkohore shqiptare",
Emine Arifi – Bakalli, fq. 46,
Prishtinë, 2011



Hasan Prishtina
(1878-1933) "Do të
mbetem armik i
Mbretërisë SKS
përderisa ky shtet nuk i
trajton drejtë shqiptarët
në Kosovë dhe
Maqedoni"

Neuss Wiener, Tagblatt,
7.4.1927; Ajet Haxhiu,
"Hasan Prishtina, The
Kosovos' Patriotic
Movement", Tirana
1968, f. 167

Burimi 2

Artikull nga gazeta "POLITIKA"

Qërim hesapesh mes emigrantëve apo atentat i porositur nga Shqipëria?
HASAN BEJ PRISHTINA, KRYEMINISTËR I MËPARSHËM I QEVERISË
SHQIPTARE VRITET NË SELANIK

Vrasësi Husein Seko, gjithashtu emigrant shqiptar, pohon se e ka vrrarë Prishtinën
sepse ai përpiqej ta bindë ta vrasë mbretin Zog I.

Selanik, 15 gusht. Dje pasdite në orën 2:15 në udhëkryqin e rrugës Ciminski dhe Bogacina para shitores "Ivi" është vrrarë me pesë plumba revolveri politikani i njohur shqiptar në emigration Hasan bej Prishtina, kryeministër i mëparshëm i qeverisë shqiptare dhe udhëheqës i emigracionit shqiptar. E vrau shqiptari Ibrahim Husein Seko, gjithashtu emigrant, me të cilin Prishtina kishte raporte miqësore. Vrasja është kryer për motive politike. Agjentët shqiptarë përpiqen ta fajësojnë Jugosllavinë për vrasjen e Hasan bej Prishtinës. Për këtë i ndihmon edhe një pjesë e shtypit të Selanikut



Selanik, 18 gusht.

Afera me atentatin ndaj udhëheqës të emigrantëve shqiptarë Hasan bej Prishtina filloi të komplikohet. Shkaku i kësaj është fshehtësia me të cilën kryhen hetimet, kështu që ende nuk dihen plotësisht rezultatet deri te të cilët kanë arritur ato.

Plotësisht papritur, edhe atë në momentet kur të gjithë e dinin vepër e kujt është atentati, në një pjesë të shtypit të Selanikut përmendet Jugosllavia, me qëllim që ajo të përzihet në këtë aferë dhe të fajësohet si frymëzuesja dhe organizatorja kryesore e atentatit. Si bazë për këtë pohim theksohet Komiteti i Kosovës të cilin Prishtina në kohën e tij e kontestonte, i cili tani nuk ekziston, si edhe gjoja ndikimi të cilin e ka Prishtina ndaj shqiptarëve që jetojnë në hapësirën e Kosovës. Kështu që këtë aferë, e cila paraqet luftë të pastër të ndërsjellë mes emigrantëve dhe regjimit aktual në Shqipëri, u përpoq ta bartë në Jugosllavi dhe atë ta fajësojë si fajtor kryesor.

Grupi 2

Opozita aktive ilegale

Pyetje:

1. Si organizoheshin njerëzit të cilët ndjeheshin të pabarabartë në shtetin në të cilin jetonin?
2. Çka i detyronte grupet e caktuara që shtetit t'i kundërvihen me armë?

Burimi 3

Azem Bejta, Udhëheqës i “Lëvizjes Kaçake” dhe Shote Galica, gruaja e tij

“Lëvizja Kaçake” (1912-1924) ishte lëvizje e armatosur e shqiptarëve në Mbretërinë SKS. Udhëheqësi i kryengritjes ishte Azem Bejta, i njohur si Azem Galica, dhe gruaja e tij, Shote Galica. Koordinator i lëvizjes Kaçake ishte Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, organizatë politike e përbërë kryesisht prej shqiptarëve të Kosovës të cilët jetonin dhe punonin në emigracion. Qëllimi kryesor i lëvizjes ishte që popullsia lokale të bindet që Kosova duhet të bashkohet me Shqipërinë.

Kjo lëvizje nga shteti shihej si organizatë ilegale, por nga ana tjetër shqiptarët lëvizjen e shihnin si lëvizje çlirimtare kombëtare. Pjesëtarët e lëvizjes tërhiqeshin në malet e Kosovës dhe luftonin si guerilë. Apelonin te qytetarët shqiptarë që të rezistojnë kundër shtetit duke mos paguar tatim dhe duke mos shërbyer në ushtri, përderisa nuk përmbushen kërkesat e tyre. Pas vdekjes së Azem Bejtës më 1924, lëvizja filloi të shuhet.

MKK e përkrahte gjithashtu Lëvizjen Kaçake brenda Kosovës (1912-1924)

Nga autoritetet e Mbretërisë SKS dhe përfaqësuesve të fuqive të mëdha, anëtarët e Lëvizjes Kaçake i konsideronin “banditë”, ndërsa Bajram Currin dhe Hasan Prishtinën i quanin “udhëheqës të banditëve”.

Z. Avramovski, Britanci u Kraljevini SKS” f. 85;

Duke dashur ta kontrolloj “Lëvizjen Kaçake”, MKK-ja në vitin 1919 vendosi disa rregulla për ta:

1. Asnjë kaçak nuk lejohet të dëmtoj asnjë serb vendas përderisa ata nuk përdorin armë kundër Shqiptarëve;
2. Asnjë kaçak nuk guxon të kallë shtëpi dhe kisha.

Edhe krahas kësaj, shumë ushtarë shqiptarë dhe xhandarë që kishin bashkëpunuar me autoritetet serbe dhe kolonët sllavë, u vranë nga ana e kaçakëve.

Ceshtje nga historia moderne dhe bashkekohore shqiptare”, Emine Bakalli-Afrifi p. 55, Prishtine, 2011



Azem Bejta
(1889-1924)
Udhëheqës i “Lëvizjes Kaçake”

Shote Galica
(1895-1927)
Gruaja e tij

Burimi 4

Qëndrimet e shqiptarëve për punën e Lidhjes së Kombeve

Bedri Pejani, anëtar aktiv i MKK-së tha: “Marrëveshja për mbrojtjen e pakicave, të cilën Mbretëria e SKS e nënshkroi në vitin 1921, ishte serum për përgjumjen e dhimbjes të pakicat, përderisa ata mbeten të dënuar nga ana e diplomacisë së lartë”.

Hakif Bajrami, “Bedri Pejani”, Prishtinë, 1994, f. 159

Grupi 3

Opozita legale

1. A i shfrytëzonte opozita legale mënyrat institucionale për t'i kompletuar qëllimet e tyre ?
2. A ishte e mundur të arrihen qëllimet politike nëpërmjet institucioneve legale politike ? Mbështete qëndrimin tënd.

Burimi 1

Partia myslimane shqiptare "Xhemijeti"

Partia legale, e cila i përfaqësonte interesat e myslimanëve shqiptarë nga Kosova dhe nga Maqedonia, është themeluar në konferencën në Shkup, në dhjetor të vitit 1919. Njihej mirë si "Xhemijeti" ose bashkësia, ndërsa emri i saj i plotë ishte Islam Muhafaza-ul Hukuk Xhemijeti (Asociacioni Islam për Mbrojtjen dhe Drejtësinë). Në fillim ata planifikonin union me Partinë Politike Islame Boshnjake, Organizatën Jugosllave Myslimane, të themeluar në Sarajevë në vitin 1919, por bashkëpunimi mes myslimanëve sllavë dhe shqiptarë nuk ishte kusht për bashkëpunim. Megjithatë kosovarët, maqedonasit dhe boshnjakët në konferencën në Shkup u morën vesh për kërkesat e përgjithshme politike: për autonominë e plotë fetare, për ruajtjen e xhamive dhe pronave të tyre, përdorimit të lirë të gjuhës popullore të të gjitha popullsive joserbe, mbrojtjen e pronës së bejlerëve nga reforma agrare.

Rrethanat shoqërore dhe politike Kosove 1918-1941", H. Bajrami., Prishtinë 1981, fq. 182,

Burimi 2

Xhemijeti – partia shqiptare myslimane në parlamentin e Mbretërisë së SKS



Në zgjedhjet parlamentare të mbretërisë SKS të vitit 1920 Xhemijeti fitoi 8 vende dhe në vitin 1923 fitoi 14 vende. Disa prej deputetëve, si Ferat Draga, ishin fuqishëm kundër politikës antishqiptare të regjimit, e kundërshtonin shpërnguljen e shqiptarëve, eksproprijimin agrar dhe kolonizimin, ndërsa kërkonin autonomi për Kosovën, hapjen e shkollave në gjuhën amtare, zhvillim kulturor etj.

Fjalor Enciklopedik Shqiptar 3, fq. 2951, Tiranë

Burimi 3

Gazeta e Xhemijetit



Nga viti 1920 Xhemijeti e botoi gazetën e quajtur "Hak" (drejtësia, e drejta, e vërteta). Duke e pasur parasysh që në atë kohë nuk ishte i lejuar shkollimi në gjuhën shqipe, gazeta botohej në gjuhën turke me alfabet arab dhe me alfabet cirilik. Krahas kufizimeve, kjo gazetë ishte dritare në botën e informatave. Krahas suksesit të saj, gazeta u ndërpre së botuari me vendim të regjimit të Karagjorgjeviqit. Botimi i gazetës u ndërpre me vendosjen e diktaturës në vitin 1929.

Burimi 4

Ramë Bllaca, anëtar i parlamentit të Mbretërisë së SKS



Në vitin 1921 në qeverinë e Nikolla Pashiqit ai ishte deputet i parlamentit për regjionin e tij. Synimi i tij personal ishte moslejimi i shpërnguljes së shqiptarëve nga Kosova.



Shtëpi banimi e ndërtuar nga Ramë Bllaca. Sipas të dhënave lokale dhe historike, ky objekt është ndërtuar rreth vitit 1937. Qëllimi i ishte që t'u bëjë me dije shqiptarëve se ai nuk shpërngulet dhe që ardhmërinë e shëh në Kosovë, që të tjerët ta ndjekin hapin e tij. Megjithatë edhe pse ishte ndërtues i saj, Ramë Bllaca nuk arriti ta shohë rezultatin përfundimtar sepse u vra në betejë më 27 gusht 1937.


Pyetje:

1. Cila ishte pozita e Shtetit Shqiptar kundrejt pakicës shqiptare në Mbretërinë SKS?
2. A kishte mundësi t'u ndihmojë Shteti Shqiptar bashkëkombësve të tyre në shtetet përreth? Mbështete mendimin tënd!

Burimi 1

Kërkesat e Shtetit Shqiptar në Konferencën Paqësore të Parisit

Kërkesat e Qeverisë Shqiptare dërguar Konferencës Paqësore në Paris në vitin 1919:



Grupi 5

Veprimet e shqiptarëve në Kosovë

Pyetje:

1. Cilën rrugë e zgjodhën pjesëtarët e pakicës shqiptare në Kosovë në angazhimin ndërkombëtar për realizimin e qëllimeve të tyre?
2. Cilat ishin qëllimet e tyre politike?

“Për shkak të promovimit të bashkëpunimit



Grupi 5

Veprimet e shqiptarëve në Kosovë

Pyetje:

1. Cilën rrugë e zgjodhën pjesëtarët e pakicës shqiptare në Kosovë në angazhimin ndërkombëtar për realizimin e qëllimeve të tyre?
2. Cilat ishin qëllimet e tyre politike?

Burimi 1

Lista e dokumenteve shtesë

Në shtojcat vijuese, do të përqipemi të tregojmë me anë të fakteve precize vërtetësinë e pohimit të cilin kishin nder ta përcjellim në këtë Memorandum. Ngjarjet e përmendura janë dhënë vetëm si shembuj dhe janë zgjedhur rastësisht nga raste të shumta të ngjashme. Që të jemi sa më të qartë, kemi dhënë referenca për normat e Marrëveshjes për Mbrojtjen e Pakicave, nënshkruese e të cilit është Mbretëria Jugosllave dhe kemi siguruar fakte të cilat do të tregojnë se normat e kësaj marrëveshjeje nuk zbatohen ndaj pakicës shqiptare. Faktet flasin vet për veten. Autenticiteti i tyre nuk mund të mohohet, bile edhe për konstatimin se hulumtimi zyrtar nuk mund të zbatohet”.

SHTOJCA 5

PËRDORIMI I GJUHËS KOMBËTARE

“Nuk do të ketë kufizime për përdorimin e gjuhës popullore (kombëtare) në fushën e fesë, shtypit ose cilitdo qoftë lloji të botimeve”. (Marrëveshja për pakicat, Neni 7)

Texts and Documents of Albanian History, Robert Elsie
http://www.albanianhistory.net/texts20_2/AH1930.html

Burimi 2

Vazhdojnë kufizimet për shqiptarët në Jugosllavi

Situata vazhdon për gjysmën e popullit shqiptar i cili jeton nën pushtetin e huaj. Disa shembuj do të jenë të mjaftueshëm për ilustrimin e vërtetësisë së këtij pohimi.

a) Nuk ekzistojnë gazeta, revista ose publikime të tjera në gjuhën shqipe për 800.000 shqiptarë në Jugosllavi. Qeveria në Beograd mund të pohojë që aktiviteti intelektual nuk është i ndaluar me ligj, por ata të cilët e zbatojnë ligjin, policia dhe zyrtarët e tjerë, bëjnë çmos që ta pamundësojnë atë aktivitet. Nëse shqiptari parashtron kërkesë për miratim të botimit të gazetës në gjuhën shqipe, të mbajë ligjërim të parrezikshëm publik në gjuhën shqipe, ose të hapë shkollë për mësimin e shqipes, ai, normalisht, nuk dënohet për kërkesën e këtillë, por menjëherë dëbohet nga ana e policisë dhe xhandarëve për të gjitha akuzat e mundshme, arrestohet, dhe në të shumtat e rasteve hidhet në burg ose i merret e tërë prona.

b) Njërit nga të nënshkruarit e mëposhtëm, Dom Shtjefën Kurti, deri para pak kohe prift i fshatit Novosellë, rrethi i Gjakovës, nga drejtori i shkollës serbe Radovan Milutinović iu ndalua të përdorë gjuhën shqipe me nxënësit për të mësuar katekizmin.

c) Kur nxënësit shqiptarë nga fshati Skivjan, rrethi i Gjakovës i sollën abetaret shqipe në shkollën serbe në të cilën shkonin, drejtori serb, z. Zoniq i konfiskoi librat dhe menjëherë i dënoi fëmijët që “morën guximin të mësojnë gjuhën që nuk është shtetërore”.

Texts and Documents of Albanian History, Robert Elsie
http://www.albanianhistory.net/texts20_2/AH1930.html

Burimi 3

Kërkesat e shqiptarëve të Kosovës pranë Lidhjes së Kombeve

Kërkesat e shqiptarëve të Kosovës drejtuar komunitetit ndërkombëtar

Në petitionet, Komitetit “*Mbrojtja Kombëtare e Kosovës*” MKK, drejtuar Lidhjes së Kombeve: “Kushtetuta e Mbretërisë SKS ishte një copë letër e vdekur...”

Ata kërkuan krijimin e komisionit neutral të Lidhjes së Kombeve, i cili do ta hulumtonte situatën në terren... të sigurojë respektimin e të drejtave të pakicës për këtë popullsi të shtypur.

L.Culaj, Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës 1918-1924, Prishtinë 1997, f.68